



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 4483 Prot.

Lezhë, më 09 / 09 / 2026

U R D H Ë R

Nr. 217., datë 08 / 09 / 2026

“PËR
KRIJIMIN E GRUPIT TË PUNËS PËR APLIKIMIN NË THIRRJËN E PESTË
PËR PROJEKT-PROPOZIME RINORE NGA AGJENCIA KOMBËTARE E
RINISË PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE”

Mbështetur në ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” Neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.1 shkronja (b), Neni 25 “Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese”, pika 4 “Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve”, Vendimin Nr. 393., datë 18.07.2022 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lezhë”, Planin Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Komunitetit të Lezhës 2013 – 2030, si dhe hapjes së Thirrjes së Pestë për projekt-propozime Rinore nga Agjencia Kombëtare e Rinisë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore;

U R D H Ë R O J:

1. Krijimin e grupit të punës për aplikimin në Thirrjen e Pestë për projekt propozime rinore nga Agjencia Kombëtare e Rinisë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore;
 1. **Znj. Brikena Vuksani** - Kryetar, me detyrë Zv/Kryetar në Bashkinë Lezhë;
 2. **Znj. Vasilika Laska** – Koordinator, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës;

3. **Znj. Aurora Reçi Gjeloshi** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve;
 4. **Z. Flamur Kuçi** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban;
 5. **Znj. Mariolina Lleshi** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit;
 6. **Z. Altin Lleshi** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë Juridike;
 7. **Z. Renaldo Xhanej** - Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Turizmit;
 8. **Z. Jurgen Marku** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit.
2. Grupi i punës do të angazhohet të përgatisë aplikimin e projekt-propozimit.
 3. Koordinator i grupit do të koordinojë informacionin brenda grupit të punës dhe të gjithë anëtarët e grupit do të angazhohen të ofrojnë informacionin dhe ekspertizën e tyre sipas fushave që mbulojnë.
 4. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet grupi i punës.
 5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Pjerin Ndreu

